

ÇMIMI I PARË

ESE

Tema: Bashkëpunimi mes Policisë dhe komunitetit të të rinjve Selenicë.

Jam një maturante nga gjimnazi “Hajredin Beqari”, Selenicë, në qarkun Vlorë. Duke marrë shkas nga një takim mes të rinjve nga ky komunitet, përfaqësuesve nga Bashkia Vlorë dhe policisë së shtetit, vendosa të shkruaj mbi marrëdhëniet që ekzistojnë sot mes të rinjve dhe policisë në qytezën tonë.

Qyteza jonë ndodhet rreth 29 km larg qytetit të Vlorës, gjithashtu edhe larg rajonit të policisë. E vetmja lidhje midis qytetarëve dhe policisë është i plotfuqishmi i zonës, i cili banon larg qytezës sonë.

Në përgjithësi Selenica është një vend i qetë, por nuk kanë munguar edhe veprime të paligjshme si: vjedhje në dyqane apo banesa të ndryshme, dhe rrallëherë edhe zënka mes të rinjve. Policia për shkak të largësisë ka arritur me vonesë në vendngjarje duke e bërë më të vështirë zgjidhjen e situatës.

Unë dhe bashkëmoshatarët e mi i përkasim një brezi delikat që shpeshherë mund të bëhet shkak i problemeve të ndryshme, të cilat mund të shoqërohen me pasojë nëse nuk do të jetë e mundur ndërhyrja e forcave të policisë. Por a e dini se çfarë impakti na krijohet kur shohim një forcë policie në qytetin tonë? Anketë dhe frikë. Të gjithë pyesim se çfarë mund të ketë ndodhur, sepse ne nuk jemi mësuar të kemi praninë e uniformave blu në ditë të qeta, ku ne të gjithë mund të ndihemi të mbrojtur duke i admiruar, falënderuar dhe respektuar në misionin e tyre të shenjtë për sigurinë tonë.

Këtë lloj impakti unë e ndjej në qytetin e Vlorës, ku shkoj shpesh. Gjatë gjithë ditës shoh forca të policisë apo makina policie që lëvizin nëpër qytet duke përcjellë energji pozitive dhe siguri tek qytetaret, të cilët ndihen të qetë, të mbrojtur dhe jo të frikësuar.

Në shkollën tonë, në raste shumë të rralla mund të ketë ndodhur ndonjë rast i vogël dhune, i cili është eliminuar me ndërhyrjen e mësuesve. Mendoj se, vizitat më të shpeshta të përfaqësuesëve të policisë në shkollën tonë do të rrisnin ndërgjegjësimin tek të rinjtë për të mos u bërë shkaktarë për raste zënkash apo dhune.

Megjithatë, puna për ndërgjegjësimin e të rinjve për denoncimin dhe parandalimin e dhunës nuk ka munguar në shkollën tonë. Mund të përmend dhe njëkohësisht të falënderoj qendrën “Vatra” për takimet e shumta që ka organizuar me të rinjtë mbi dhunën, shkaqet, pasojat dhe mënyrat e parandalimit të saj.

Një takim tjetër i rëndësishëm ishte dhe ai mes të plotfuqishmit të zonës sonë dhe përfaqësuesëve të Bashkisë Vlorë, ku u diskutua gjerë e gjatë mbi problemet e dhunës tek të rinjtë dhe ku të rinjtë u informuan dhe u pajisën me numra kontaktesh nga policia e shtetit, për çdo rast të pakëndshëm dhe të padëshirueshëm dhune që mund të ndodhë mes të rinjve.

Do të ishte ndihmesë e madhe për komunitetin tonë, nëse strukturat e larta të policisë së shtetit vendosin për rifunksionimin e postës së policisë në qytetin tonë, ashtu si dikur.

Kështu, ne banorët do të ndiheshim më të qetë gjate orëve të natës, më të sigurtë gjatë ditës dhe personat e dhunshëm do të mendoheshin shumë për të krijuar situata të pakëndshme konfliktesh dhe dhune.

Në mbyllje të këtij shkrimi, unë do të shprehja në emër të gjithë bashkëmoshatarëve të mi, mirënjohjen dhe respektin për të gjitha forcat e policisë së shtetit, të cilët, duke kryer misionin e tyre human në mbrojtje të sigurisë dhe qetësisë së qytetarëve, nuk janë tërhequr përballë dhunës dhe krimit, por kane rrezikuar duke mos kursyer as jetën.

Jemi krenare për ju!

Punoi: Redjola Hoxhaj

Nxënëse e klasës XII B

Shkolla e mesme e përgjithshme “Hajredin Beqari”, Selenicë, Vlorë

ÇMIMI I II

ESE

Tema: Dhuna, shfaqje e shëmtuar e shoqërisë, bashkëpunimi RINI - POLICI për denoncimin e dhunës është shumë i rëndësishëm.

Përditë, ne jemi dëshmitarë të një fenomeni, i cili po e dobëson shoqërinë pak nga pak, nga dita në ditë, një fenomen, që godet në zemrën e njeriut, qenien njerëzore duke e rrëzuar dhe në këtë moment askush nuk mundet ose me mire askush nuk dëshiron të bëhet një shtyllë ku personi i sulmuar të rikthehet serish në rrugën e jetës. Dhunë dëgjohet, dhunë lexohet, dhunë shkruhet në çdo drejtim që në marrim dhe tashmë është bërë një himn, një refren, një ngjarje e përditshme për këdo. Dhuna vret gra, fëmijë dhe vajza.

Por ç'faj kanë femrat e brishta, vajza e pambrojtura, fëmijët e pafajshëm, njerëzit pa mbështetje që bien pre e dhunës ?????

Pse duhet të durojmë përditë dhimbje dhe asnjë fjale të ngrohtë????

Pse duhet të qëndrojmë të mbyllur, duke vuajtur psikologjikisht, por edhe fizikisht? A nuk duhet të jemi ne ata që duhet t'i nxjerrim nga ajo botë e errët, plot me fantazma dhe hije? A nuk duhet t'u shtrëngojmë dorën kur e zgjasin drejt nesh për të kërkuar ndihmë? Jam unë, je ti, janë ata, jemi të gjithë se bashku ne, që mund ta shpëtojmë shoqërinë.

Ne mund t'i presim kthetrat e saj, që ajo të mos godasë më. Në fund të fundit, a ka shfaqje më të shëmtuar se dhuna?

Jo, shfaqja e saj prek, të shkakton dhimbje, vuajtje dhe vret thellë. Shumë njerëz kënaqen duke shijuar këtë shfaqje të shëmtuar, por kjo shfaqje nuk është një teatër, telenovelë, film apo komedi që ne ëndërrojmë ta shohim deri në fund. Jo, në këtë shfaqje bëhet fjalë për jetë njerëzish.

Ne jemi shpresa e shoqërisë për të shpëtuar jetë, jemi rinia, motiv agjent ndryshimi, e ardhmja, jemi varka e shpëtimit në një det pa fund, jemi bashkëpunimi me organin e shtetit që na mbështetet, me policinë.

Në çdo rast dhune, ne nuk duhet të jemi publiku por shpëtimtarë, veçse me një telefonatë në numrin 129, ne u kërkojmë ndihmë forcave tona të policisë, të cilat punojnë pa asnjë detyrim kundrejt nesh, ata dëshirojnë veçse paqe dhe harmoni midis nesh.

Ky bashkëpunim do të arrijë ta mund dhunën, ta shpërbej atë, duke nisur një etapë të re pa përdorur fjalën dhunë në shoqëri dhe pa e kërkuar në fjalor.

Nuk ka gjë më të keqe se të shohim një fëmije tek vuan, tek qan me britmë, tek i mbeten shenjë gjurmët e dhunës. Nuk ka gjë më të hidhur sesa të dëgjosh gjithkund fjalën "dhunë", sesa të shikosh kudo dhunën, dhe të mos dish të bësh diçka, të mos pasqyrosh dot mirësi.

Por, në çdo situatë gjithçka e ka një zgjidhje, një rrugëdalje dhe kjo është bashkëpunimi midis policisë dhe nesh.

Punoi: Merushe TOJALLI

Nxënëse

Shkolla e mesme e përgjithshme Novoselë, Vlorë

ÇMIMI I III

ESE

Tema: Të rinjtë dhe policia

Progresi social zhvillohet në vija paralele me faktorët që e stimulojnë rolin aktiv të tij dhe personifikojnë në detaje çdo hap të hedhur në rrugën premtuese të së ardhmes. Këta faktorë ndryshojnë pozicion apo subjekt, por sërisht ata mbështeten tek e vetmja force publike e cila është rinia, objektivi me aktiv dhe frytdhënës në jetën sociale apo administrative.

...Mardhënia diktuese mes të rinjve dhe policisë është si një horizont i gjerë nëpër të cilin kalon legjitimiteti, drejtësia, stabiliteti apo edhe bestytia, sepse afishimi i rregulloreve etike merr si shabllon të tijin individët që e zotërojnë profesionin fisnik dhe akumulues të policit. Me gjithë vështirësitë apo dhe satisfaksionin që të jep një profesin i tillë, përsëri idealet që rrisin besimin tek ai, duhet të jenë tepër të fortë për të përballuar një përplasje morale ose karakteresh me të rinjtë, të cilët kanë devijuar nga kultura ligjore apo interpretimi i saj.

...Policia përballlet me një rini të dhunshme, me jetën dhe personalitetin e tyre apo shoqërisë, sepse ata bëhen konsumatorë apo shpërndarës të lëndëve narkotike, kryejnë vepra të dhunshme apo gjenden si faktorë pengues në rregullimin e marrëdhënieve njeri – mjedis. Zbatimi deri në detaje i ligjit nga njerëz të cilët japin produktivitet në institucionet ekzekutuese, tregon respekt mbi lirinë e fjalës apo veprimet deri në pikën ku nuk cenohen të drejtat e tjetrit dhe sjellin një organizim tepër të qytetëruar në shoqërinë publike.

Por, shpesh janë të rinjtë ata, që ndihen të pambrojtur nga aktiviteti reformues i policisë, duke mos patur mundësinë të përfitojnë të drejtën e tyre për tu shfaqur me mendimin e tyre objektiv në hapësirat rrethuese. Organet më të rëndësishme të ruajtjes dhe mbarëvajtjes ligjore duhet të përdorin raste të tilla si një hajmali, e cila prek interesin publik në formë origjinale dhe ndihmon në progresin social.

Mbi çdo shkak apo pasojë, rëndësi themelore ka ndërgjegjësimi publik për të promovuar në baza konkrete dhe të disiplinuar, me qëllim njohjen e ligjit, ekzekutimin dhe koordinimin e tij si nga të rinjtë problematikë apo edhe nga vetë punonjësit e policisë. Secili prej nesh duhet të mbështesë arritjet e tij mbi progresin dhe ai është thjesht një fryt i drejtësisë, respektimit të ligjit dhe ngritjes së përgjegjësisë publike.

Punoi : Miledi Abazi,

Nxënëse

Shkolla e mesme e përgjithshme “Jani Minga”, Vlorë